

Ftesë për aplikim

Argëtimi i sotëm, punësim në të ardhmen

Kampet lokale verore në Mitrovicë dhe Gjilan, të mbështetura nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në bashkëpunim me Zyrat Publike për Punësim në komunat përkatëse do të sjellin 25-30 të rinjë nga secili rajon për ndarë mes vete përvojat, me theks të veçantë në aktivitetet për orientimin në karrierë.

Kampi veror do të ketë karakter aktiv dhe do t'ju udhëzoj përmes përmbajtjeve të ndryshme trajnuese – nga puna në grupe në inpute praktike për punësim, nga aftësitë e të shkruarit tek aftësitë për prezantim, nga salla për trajnim tek terrenet sportive dhe natyra.

Kampet verore synojnë të mbështesin të rinjtë që të marrin vendime të informuara për karrierat e tyre të ardhshme dhe të përmirësojnë punsueshmërinë e të rinjve në Kosovë përmes të mësuarit të bazuar në aktivitete.

A jeni...?

- Kureshtar për perspektivën tuaj në të ardhmen?
- Të etur që të mësoni në mënyrë aktive?
- Kureshtar që të takoni miq të ri dhe të gatshëm të shkëmbeni përvojat tuaja?
- Të interesuar që të zhvilloni CV-në, letrën motivuese dhe aftësitë tuaja prezantuese?
- Të gatshëm për përvoja të reja sportive?
- Të prirur që të thelloni aftësitë tuaja personale dhe profesionale?
- A jetoni në rajonin e Mitrovicës dhe Gjilanit?

Kush mund të përfitoj?

- Të rinjtë e moshës 18-21 vjeçar
- Të rinjtë e papunësuar dhe që nuk janë duke ndjekur shkollimin apo trajnimin (inkurajohen të aplikojnë gratë, pjesëtarët e minoriteteve, të kthyerit dhe grupet e cënueshme)
- Të rinjtë e regjistruara në Zyrat për Punësim.

Kur dhe ku?

Në Mitrovicë nga 25 deri më 29.07.2022 , në Villa Vllahia

Në Gjilan nga 08 deri më 12.08.2022, në Villa Lura Agrotourizëm, Makresh i Epërm

Si të aplikoj?

Ju lutem plotësoni formularin e aplikacionit dhe dërgojeni tek zyra për punësim deri më datën 10.07.22.

Për të aplikuar në kampin veror të Mitrovicës, të gjithë të interesuarit nga rajoni i Mitrovicës duhet të dorëzojnë aplikacionin e tyre në këtë email Ardita.sadiku@rks-gov.net

Për të aplikuar në kampin veror të Gjilanit, të interesuarit nga rajoni i Gjilanit duhet të dorëzojnë aplikacionin në këtë Ismet.gagica@rks-gov.net.

Informata shtesë në lidhje me organizimin:

Gjuha e punës: shqip, anglisht dhe serbisht

Shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit do të mbulohen nga organizatori.

Do të sigurohet transporti për/nga Mitrovicë/Gjilan.